



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.861/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidaten për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Ilirjana Toplanaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Klinës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.861/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës, Ilirjana Toplanaj nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Klinës, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin Anr.861/2021 me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në të cilën pretendon se në vendvotimet VV 0805C/01R, VV 0805C/02R, VV 0805C/03D, VV 0817C/01R nuk i figuron asnjë votë mirëpo nga deklaratat e votuesve të tij sipas të njëjtës dyshon se se votat nuk i janë nuëruar saktë dhe në vendvotimin VV 0817C/02D i figurojnë vetëm 2 vota derisa pretendon se duhet të kishtë më shumë. Sipas parashtruses së apelit numri total i votave të saj sipas rezultatit përfundimtar zyrtar nga KQZ rezulton se ka 282 vota derisa thekson se duhet të kishtë gjithsej 296 vota ashtu siç është njoftuar nga zyrtarët komunal zgjedhor në Klinë pas përfundimit të procesit të numërimit të votave. Andaj përmes apelit të parashtruar ka kërkuar që të bëhet rinumërim në venvtoimet e theksuara si më lartë. Në mbështetje të pretendimeve të saja ka bashkangjitur si dëshmi një sms si foto.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Klinës Ilirjana Toplanaj, nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, brenda afatit ligjor ka parashtruar apelin ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimet VV 0805C/01R, VV 0805C/02R, VV 0805C/03D, VV 0817C/01R dhe në vendvotimin VV 0817C/02D.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret apeluasja nuk ka bashkangjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën i vërteton pretendimet e saja, mirëpo Paneli verifikoi se në vendvotimet e pretenduara si në apel Ilirjana Toplanaj nga Subjekti Politik AAK kishte gjithsej 2 vota ashtu siç edhe ka pretenduar derisa nga rezultatet zyrtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rezulton se apeluasja gjithsej numrin total të votave e ka 282.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.861/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Kondrshajevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.